

LEDIANA BESHAI

**NJËSITË FRAZEOLOGJIKE TË FORMUARA ME METAFORË DHE
PËRDORIMI STILISTIK I TYRE NË SHQIPE DHE ANGLISHTE**

Hyrje

Përgjithësisht, njësitë frazeologjike të formuara me metaforë janë më të shumta në numër. Sipas Lakoff-it dhe Johnson-it, shumica e metaforave në gjuhën e përditshme kanë një natyrë konvencionale, që do të thotë se ato janë shprehje të qëndrueshme që përdoren nga njerëzit në mënyrë sistematike. Për këta studiues metaforat konvencionale krijohen nga kultura e një vendi të caktuar për të përcaktuar një lloj realiteti të veçantë. Ndikimi i kulturës në formimet metaforike shihet dhe është i pranishëm kudo, në ligjërimi të ndryshme dhe në stile të ndryshme. Për Lakoff-in dhe Johnson-in¹, kuptimi i metaforave të reja varet dhe përcaktohet një pjesë nga kultura dhe një pjesë nga eksperiencat personale të përdoruesit. Përdorimi i duhur i metaforave nuk është një proces i thjeshtë i të kopjuarit të njëjësive metaforike të pandryshueshme të një grupi social, por ka gjithmonë një element individual për rindërtimin e metaforave që burojnë nga kultura, sepse njerëzit ndikohen nga eksperiencat personale dhe nga ekspozimi ndaj ligjërimëve sociale të shumëllojshme. Sipas V. Memishës lindja e një frazeologjie përmes metaforizmit është një proces katërshkallësh: togfjalësh i lirë – krahasim – metaforë (që nënkupton rënien e lidhëzës krahasore) – njësi frazeologjike (lindja e një njësie të re leksikore me të gjitha vlerat dhe funksionet që ka dhe barasvlerësi i saj, fjala).² Sipas tij, shqipja është në një fazë **metaforizimi** shumë të fuqishëm, prirje kjo e gjuhëve me stile funksionale shumë të përpunuara. Strukturat minimale ku ndodh ky metaforizim (jo metaforizim në kuptimin e ngushtë, por si lëvizje kuptimore përfshirëse) se ndërtojnë bashkëlidhje të shumta fjalësh dhe pasurojnë me valenca të reja semantike strukturat e tyre.³

Nëpërmjet metaforës në gjuhën shqipe lindin shumë kuptime, sipas ngjashmërisë së sendeve nga forma, nga madhësia, nga ngjyra, nga ashpërsia, nga lënda ose nga tipare të tjera konkrete e abstrakte; pra, mund të themi se kjo mënyrë mbetet një rrugë e hapur për pasurimin e fjalëve me kuptime të reja. Në këtë këndvështrim metafora na shfaqet si mjeti kryesor për krijimin e njëjësive frazeologjike dhe si procesi më prodhimtar në gjuhë. Shembuj e shumë që kemi vjelë⁴, nga shqipja e nga anglishtja e dëshmojnë këtë gjë, p.sh:

¹ G. Lakoff & M. Johnson (1980), *Metaphors we live by*, Chicago, Chicago University Press, f. 142.

² V. Memisha (2011), *Studime për fjalën shqipe*, f. 88.

³ V. Memisha, *Rreth intelektualizimit të leksikut të shqipes*, në Seminari II Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2008, f. 196.

⁴ I. Stefanllari (1998), *Fjalori frazeologjik anglisht – shqip*.

~ **Bad egg** – njeri i poshtër, njeri i keq, maskara; njeri i pabesë

Their nephew, who was a real bad egg, got his hands on nearly all the old couple's savings on the pretext that he would buy them a little place in the country.

I would never trust Brown: he is a bad egg.

~ **Big cheese / shot / wheel / wig** – njeri me peshë, njeri me zë, njeri me shumë rëndësi

Here comes the big cheese himself. Have got the red carpet yet?

Make sure you keep friendly with that chap: he's a big shot in the Civil Service.

~ **Cold fish, a** – njeri i ftohtë

I find Frank's company boring: he's a bit of a cold fish.

~ **Dark horse, a** – person (kandidat) pak i njohur njeri i pashfaqur

He's a bit of a dark horse: He was earning a fortune, but nobody knew. Whatever the outcome of the election, Mr. Michael Foot-the dark horse- emerges more and more as a figure of moderation.

Ndërsa në shqip⁵:

~ **Arushë mali (e malit)** njeri i fuqishëm e i guximshëm; njeri që nuk lodhet kurrë. *Kur i therrët ai Sokoli Halil: / "Ku më je, i thotë, arusha e malit, / Ndihmë do të vijmë agët e Jutbinës. (Folk.). Dalip Karaji, një arushë mali, / I ra asqerit mu te zalli. (Folk.).*

~ **Bagëti e trashë shar.** njeri i paditur, i pagdhendur a budalla. - *Fali Zot, bagëti e trashë, nuk dinë ç'bëjnë. (Let. art.).*

~ **Bletë shkëmbi** njeri i padobishëm, që nuk jep fryte në punë; **kalli pa bukë.** - *Ma kanë sjellë një sekretar, po ai bletë shkëmbi, më mirë të mos e kesh. (Pub.).*

~ **Bollë e vrarë** njeri fare i lodhur e i këputur; që s'ka fuqi fare e s'lëviz dot. - *Ku më je, o bollë e vrarë, që s'po të shohim ka ditë? (Ligj. fol.).*

~ **Buf kënete shar.** njeri i shëndoshë, i plogët e përtac, njeri i fjetur; njeri i trashë nga mendja. - *Kush që ai buf kënete që t'i tha këto gjëra? Dysjoj shumë në intelektin e tij. (Let. art.).*

~ **Me buzë të plasur** shumë i dëshpëruar, i pikëlluar; **me shpirt të plasur; me zemër të plasur.** *O moj Shqipëriz' e dashur, / Mëmëdhe, / Të shoh me buzë të plasur, / Si më sheh. (Let. art.).*

~ **Me buzë varur (të varur)** i vrenjtur, i ngrysur, i zemëruar; i pakënaqur e i mërziutur; **gjithë (tërë)buzë; (gjithë, tërë) hundë e buzë; me hundë varur (të varura).** *Përse sot me buzë varur ky Çurçilli, / Këtë ditë kur me gaz këndon bilbili? (Let. art.). Me buzë të varura i rrinte edhe plaka, që më parë e priste me peqe e lepe. (Let. art.).*

~ **Dash me flokë** burrë i shquar, burri më i mirë në një fshat, në një rreth familjar etj.; **dash me këmborë.** - *Shpendi ka qenë dash me flokë në të tanë krahinën e jo vetëm në katundin tonë. (Ligj. fol.).*

~ **Dash me këmborë.** 1. Njeri i zoti e i shquar, i pari ndër të tjerët; **dash me flokë.** - *E ka atë djalë në vogël, dash me këmborë, ai ka për ta nxjerrë në selamet Zenon.*

⁵ J. Thomai (1999), *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*.

Njësitë frazeologjike të formuara me metaforë dhe përdorimi...

(Ligj. fol.). 2. Kryetari i familjes a i fisit. - *Ti je dashi me këmborë në fis, ç'të na thuash ti do të bëjmë.* (Ligj. fol.). 3. Udhëheqës, prijës.- *Printe para me shpatë në dorë, / Ballë trimash dash me këmborë.* (Folk.).

~ **Derr në kotec (në thark)** shumë i mërziur (ngaqë nuk kam dalë a nuk kam lëvizur).

- *Kam gjashtë muaj pa dalë, mbeta brenda e u bëra derr në thark.* (Let. art.).

~ **Derr me zile shar.** njeri shumë i trashë nga mendja dhe i neveritshëm.

- *More, derr me zile, ç'më vure kështu në kokë? - Mbaje me shëndet! -i tha Kadriu dhe i shkeli syrin.* (Let. art.).

~ **Dhelpër plakë** (e vjetër) njeri shumë dinak, i regjur në hile e dredhi; **skile e vjetër.**

- *Ai, i dashur, ka qenë dhelpër plakë... E vlerësoi gjendjen dhe e ktheu drejtimin e barkës nga perëndimi.* (Let. art.).

~ **Dhi arrakate shar.** vajzë që nuk mblidhet në shtëpi, që bredh poshtë e përpjetë; vajzë e egër, e pashtuar në punë a në shkollë; dhi e egër.

Lushja dhi arrakate ka qenë që e vogël, dy gurë bashkë nuk linte, dhe ashtu mbeti. (Let. art.).

~ **Dhi e egër** vajzë a grua e gjallë a e shkathët, por jo e afrueshme; **dhi arrakate shar.**

Përdorimi stilistik i njësive frazeologjike

Njësitë frazeologjike përdoren nga folësi ose shkrimtari, i cili ka si qëllim një efekt të veçantë stilistik, si dhe përdoren në përputhje me një gjini të caktuar, të cilat konsiderohen si stile funksionale të ndryshme⁶. Duke i krahasuar, përqasur dhe duke dhënë shembuj të njësive frazeologjike në lloje të ndryshme të stileve funksionale synojmë të kemi të qartë dhe t'i shohim realisht që ato janë të pranishme jo vetëm në ligjërimin bisedor dhe në nivelin e bashkëbisedimit, por ato shtrihen nga letërsia artistike në atë joartistike. Shtresimi stilistik lind marrëdhënie të ndërlikuara, i jep visarit gjuhësor ngjyrat që të vizatohen tablotë e jetës, që nëpërmjet përfatesave të shfaqen mendimet e ndjenjat me forcë shprehëse. Ligjëruesi i shfrytëzon këto mundësi për një komunikim shumëfunksional⁷. Potenciali artistik i njësive frazeologjike është tepër i madh.“ Përderisa njësitë frazeologjike mund të jenë mjete të rëndësishme stilistike, ato janë evidenca të një niveli, brenda një sistemi stilistik i cili është quajtur ‘frazeo-stilistika’ (Gläser 1986b), e cila kombinon aspektet komunikuese dhe sistemet e analizës gjuhë-stilistike⁸.

Stili në ligjërim është një çështje e komplikuar. Përsa i përket frazeologjisë, stili është thelbësor në analizimin e shprehjeve frazeologjike në ligjërim, si dhe për të përcaktuar rolin që shprehjet frazeologjike luajnë në ndërtimin e kuptimeve

⁶ Xh. Lloshi (1999), *Stilistika dhe pragmatika*, ShB “Toena”, Tiranë, f. 186.

⁷ Xh. Lloshi (1999), *Stilistika dhe pragmatika*, ShB “Toena”, Tiranë, f. 186.

⁸ R. Gläser (1986b), *Linguistics Across Historical and Geographical Boundaries*, Volume 1, edited by Dieter Kastovsky, A. J. Szwedek, Jacek Fisiak, f. 43.

sipas llojit të tekstit. Një qasje e orientuar drejt kontekstit do të thotë që ndryshimet stilistike nuk ndodhin në izolim, por vetëm si pjesë integrale e ligjërimit⁹. Në varësi të formës së komunikimit pothuajse të gjithë autorët bëjnë dallimin ndërmjet ligjërimit të shkruar dhe të folur, si edhe vendosin lidhjen ndërmjet ligjërimit të shkruar dhe bisedor.

Gjuha standarde, si forma më e lartë që zgjedh dhe përpunon mënyrat e marrëveshjes dhe shprehjet gjuhësore, përdoret në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore, por secila fushë i zgjedh dhe përdor këto mjete gjuhësore sipas kërkesës së vet. Sistemi i mjeteve gjuhësore, i zgjedhur në përputhje me kërkesat e një fushe të caktuar të veprimtarisë njerëzore përbën sistemin funksional. Me fjalë të tjera, stili funksional është forma që merr standardi për të plotësuar nevojat në një fushë të caktuar të aktivitetit njerëzor. Njësitë frazeologjike si elemente të larmishme në gjuhë janë të pranishme në të gjitha stilet funksionale stilistike¹⁰.

Të jesh i vetëdijshëm ndaj stilit do të thotë se është e rëndësishme të dish, të kuptosh dhe të vlerësosh gjuhën që ne përdorim duke përfshirë si tekste në letërsinë artistike dhe atë joartistike. Duke u përqendruar në përdorimin e gjuhës dhe në elementet stilistike, studiuesit janë përpjekur të kombinojnë qasjen gjuhësore me qasjen kritike letrare në një interpretim të veçantë, duke i konsideruar të dyja, formën funksionale dhe atë poetike. (Jacobson, 1960)¹¹.

Gjuha standarde ekziston dhe vepron në formën e stileve funksionale. Krijimi dhe zhvillimi i stileve funksionale lidhet ngushtë me zhvillimin e vetë gjuhës standarde¹². Në standardin e gjuhës së sotme shqipe stilet funksionale janë vendosur tashtëm së bashku me karakteristikat e tyre të përgjithshme. Stilet funksionale dallohen veçanërisht nga sfera e komunikimit dhe funksionet gjuhësore¹³. Duhet të konsiderojmë si kriter kryesor funksionet e veçanta gjuhësore, të cilat “nga pikëpamja stilistike janë një formë për t’iu përshtatur strukturës së ligjërimit për lloje të ndryshme aktivitetesh dhe është realizimi i funksioneve gjuhësore në një sferë”¹⁴.

Në gjuhën shqipe merren si dy boshte dy kriteret gjuhësore bazë, norma si bosht vertikal dhe funksionet mbizotëruese si bosht horizontal. Kjo ndarje bën që sistemi stilistik i gjuhës shqipe të jetë sa më i plotë dhe i përgjithësuar¹⁵.

Stili i veprimtarisë letrare- artistike dhe njësitë frazeologjike

Stili i veprimtarisë letrare - artistike është gjuha e veprave letrare dhe këtu është e rëndësishme të zgjidhen mjetet gjuhësore të duhura si dhe gjinia, tema, periudha në të cilën historia vendoset, personazhet, këndvështrimet e autorit dhe

⁹ Xh. Lloshi (1999), *Stilistika dhe pragmatika*, ShB “Toena” Tiranë, f. 186.

¹⁰ J. Thomai (2006), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, f. 296.

¹¹ R. Jacobson (1960), *Closing Statement: Linguistics and Poetics*, in “Style in Language” (ed. Thomas Sebeok), f.32

¹² J. Thomai (2006), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, f. 296.

¹³ Xh. Lloshi (1987), *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, f. 14.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ V. Ristani (2010), *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*, f. 39.

Njësitë frazeologjike të formuara me metaforë dhe përdorimi...

kapaciteti gjuhësor etj. Potenciali stilistik është më i pasur dhe më i shumëllojshëm në letërsi. “Gjuha e veprave letrare dallohet për përdorimin e fjalëve të zgjedhura, “kumbuese” dhe që “tingëllojnë bukur”, fjalë të cilat shprehin më mirë ndjenjat dhe qëndrimin e autorit”¹⁶. Funksioni i veçantë i gjuhës në letërsinë artistike është funksioni estetik: gjuha jo vetëm mishëron një përmbajtje, jo vetëm kumton një informacion letrar, por edhe synon të ketë ndikim estetik. Prej kësaj rrjedhin karakteristika, që e dallojnë ligjërimin artistik deri në atë shkallë, sa kemi të bëjmë madje me një tjetër gjuhë.¹⁷

Si pasqyrim artistik i jetës, i botës, letërsia përdor shumë figurat letrare, por edhe tropet gjuhësore.

[“Harrova fare që ishim të zemëruar me njëri-tjetrin. Ai doli **hundë e buzë**. ”
(Ismail Kadare “Kronike në gur” f. 240)]

Hundë e buzë është njësi frazeologjike mbiemërore e përbërë nga dy gjymtyrë emërore, kuptimi i së cilës është ‘i mërziutur, i ngrysur dhe i zemëruar’ sipas shpjegimit që i bëhet kuptimit të njësisë në fjalorin frazeologjik të Jani Thomait.

Në anglisht do të kishim:

[Now, you are to understand that King Charles the First — of his own determination to be a **high and mighty** King not to be called to account by anybody, and urged on by his Queen besides — deliberately set himself to put his Parliament down and to put himself up. You are also to understand, that even in pursuit of this wrong idea (enough in itself to have ruined any king) he never took a straight course, but always took a crooked one.

(Charles Dickens “CHAPTER XXXIII — ENGLAND UNDER CHARLES THE FIRST”)]

Poezia dhe njësitë frazeologjike

Tiparin themelor të ligjëritimit poetik e përbën organizimi në të gjitha nivelet e gjuhës. Ai përfaqëson një rivlerësim tërësor të përdorimit të gjuhës, ku marrin vlerë përfatesat fonetike, prozodike, shkrimore, morfematike, leksikore, semantike sintaksore dhe mbisintaksore.¹⁸ Leksiku i poezisë përfshin fjalë të poezisë popullore të brezave të mëparshëm dhe të tanishëm. Sipas temës që shkrimtari vendos të shkruajë ne do të gjejmë fjalë dhe shprehje, të cilat i përkasin fushave të ndryshme të jetës¹⁹.

Kështu, në baladë, në poemë ose në poezi për një arritje në teknikë, për një figurë a për një ngjarje të shënuar historike etj., do të gjejmë edhe terma dhe shprehje frazeologjike. Fjalët zgjidhen me kujdes²⁰. Gjuha shqipe ka një folklor të pasur dhe na sjell një larmishmëri figurash. Le të shohim disa vargje nga Naim Frashëri në poezinë e tij për heroin tonë kombëtar “Skënderbeun”.

Krujë, o qytet i bekuar,

¹⁶ J. Thomai (2006), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, f. 297.

¹⁷ Xh. Lloshi (2005), *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, f. 241.

¹⁸ Xh. Lloshi (1999), *Stilistika dhe pragmatika*, f. 265.

¹⁹ J. Thomai (2006), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, f. 296.

²⁰ J. Thomai (2006), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, f. 297.

*Prite, prite Skënderbenë,
Po vjen si pëllumb i shkruar,
Të shpëtojë mëmëdhenë. (Let. art.).*

Sipas fjalorit frazeologjik të gjuhës së sotme shqipe kemi:

(Si) pëllumb i shkruar poet. shumë i bukur.²¹

Pra, kemi të bëjmë me një njësi frazeologjike të formuar me anë të shndërrimit të figurshëm të njësisë me anë të krahasimit.

Në gjuhën angleze Oscar Wilde shkruan në një varg të poezisë së tij “Apologia” **a heart of stone**. Sipas fjalorit “Mc Graw-Hill Dictionary of American Idioms and Phrasal Verbs. © 2002 by The McGraw-Hill Companies, Inc.” njësia: **have a heart of stone** ka këtë shpjegim- *Fig. to be cold and unfriendly.*

Perchance it may be better so--at least
I have not made my heart **a heart of stone**,
Nor starved my boyhood of its goodly feast,
Nor walked where Beauty is a thing unknown.

Të studiosh shembuj të ndryshëm poezish në të cilat përdoren njësi frazeologjike që formohen me anë të tropeve gjuhësore të ndryshme si metafora, metonimia etj., na ndihmon të krijojmë një ide sesi përdoren ato në lloje të ndryshme poezish dhe ngjyrimin stilistik që ato transmetojnë nëpërmjet përdorimit të tyre.

Proza dhe njësitë frazeologjike

Në prozë është vështirë të gjesh një vepër letrare, pa një pasuri sado të vogël me frazeologji. Aty pasqyrohet çdo fushë e jetës dhe ka një leksik mjaft të gjerë dhe të gjithanshëm për vetë faktin se përfshihen ngjarje nga çdo fushë e veprimtarisë shoqërore²². Prandaj edhe leksiku i veprave letrare është i pasur dhe i gjithanshëm. Kjo varet nga tema që trajtohet. Në fjalorin e veprave artistike përfshihen fjalë me ngjyrimë emocionuese-shprehëse, fjalë të zgjedhura, që mund të tipizojnë si duhet figurat artistike e mjediset shoqërore, fjalë të ligjëritimit të thjeshtë e fjalë krahinore, fjalë të reja të krijuara nga autori etj.²³

Për shkak të gjerësisë e të mungesës së organizimit sipas një norme të vetme, ka autorë që gjuhën e letërsisë artistike nuk e marrin si stil të thjeshtë funksional, por si një tërësi stilesh e ligjërimesh të ndryshme. Gjithsesi, ligjërimi i shkrimtarit i përmbahet rregullisht standardit, kurse ligjërimi karakteristik i personazheve u përshtatet kërkesave stilistike dhe mjetet gjuhësore në këtë ligjërim jashtë standardit fitojnë vlerat e stilemave. Në përgjithësi leksiku i letërsisë artistike dallohet për funksionin e dyfishtë: fjala aty mund të përdoret me kuptim të drejtpërdrejtë dhe me kuptim të figurshëm²⁴. Një ndër shkrimtarët më të mirë në prozë në letërsinë angleze konsiderohet Oscar Wilde dhe kritika e cilëson si

²¹ J. Thomai (2000), *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, f. 592.

²² J. Thomai (2006), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, f. 297.

²³ J. Thomai (2006), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, f. 297.

²⁴ J. Thomai (2006), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, f. 299.

Njësitë frazeologjike të formuara me metaforë dhe përdorimi...

shkrimtarin që ka pasur një ndikim të madh në kulturën bashkëkohore, për shkak të stilit të veçantë të tij.

Të marrim disa shembuj të njësive frazeologjike të përdorur nga ai.

[LORD DARLINGTON. *I think life too complex a thing to be settled by these **hard and fast** rules.*

LADY WENDEMERE. *If we had “these **hard and fast** rules”, we should find life much more simple.*

LORD DARLINGTON. *You allow of no expectation*

(Oscar Wilde “Lady Windermere’s Fan”, f. 5)]

Hard and fast – njësia frazeologjike përkthehet “i rreptë, i prerë” në Fjalorin frazeologjik të I. Stefanllarit²⁵.

[“No, it is true, still today you are **like a dog in the manger**, for what is it to you whether the women are taken up with him or not, especially if it is such a help to him in his career?”

(Oscar Wilde “Tenely, Or, the Reverse of the Medal” f. 16)]

Kuptimi i njësisë frazeologjike **dog in the manger** është *egoist*²⁶.

Si përfundim mund të themi që metaforizimi është një proces shumë i fuqishëm dhe më prodhimtari për krijimin e njësive frazeologjike, si në shqipe ashtu edhe në anglishte. Sa i takon përdorimit stilistik të njësive frazeologjike të formuara me metaforë, vërejmë se autorët bëjnë përzgjedhjen e tyre stilistike në varësi të individualitetit të tyre krijues. Për disa autorë, përdorimi i njësive frazeologjike identifikon krejt krijimtarinë e një autori.

BIBLIOGRAFI

G. Lakoff & M. Johnson (1980), *Metaphors we live by*, Chicago, Chicago University Press.

I. Stefanllari (1998), *Fjalor frazeologjik anglisht shqip*.

I. Stefanllari (1998), *Fjalori frazeologjik anglisht – shqip*.

J. Thomai (2006), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*.

J. Thomai (2011), *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*.

R. Gläser (1986b), *Linguistics Across Historical and Geographical Boundaries*, Volume 1.

R. Jacobson (1960), *Closing Statement: Linguistics and Poetics*, in “Style in Language” (ed. Thomas Sebeok).

V. Memisha (2011), *Studime për fjalën shqipe*.

V. Memisha, *Rreth intelektualizimit të leksikut të shqipes*, në Seminari II Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2008.

V. Ristani (2010), *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*.

Xh. Loshi (1987), *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*.

Xh. Lloshi (1999), *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë.

Xh. Lloshi (2005), *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë.

²⁵ I. Stefanllari (1998), *Fjalor Frazeologjik Anglisht Shqip*.

²⁶ Po aty.

